



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“SHËRBIME SOCIALE DHE SHËNDETËSORE”

Niveli II në KSHK¹, referuar nivelit II të KEK²

O-II-22

Tirane më, 2023

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	SHËRBIME SOCIALE DHE SHËNDETËSORE"			Kodi
Kohëzgjatja	1900-2100 orë	Niveli	II në KSHK, referuar nivelit II të KEK	O-II-22
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Shërbime sociale/shëndetësore”, niveli II-të në KSHK, referuar nivelit II të KEK, është të përgatisë punonjës me kualifikim bazë për ndihmës në shërbimet sociale dhe shëndetësore, si dhe të aftësojë individët për t`u përshtatur mjedisit fizik dhe social në të cilin jetojnë.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional, që ofrojnë kualifikim profesional në “Shërbime sociale dhe shëndetësore” të nivelit të II-të në KSHK, referuar nivelit II të KEK, kanë të drejtë të hyjnë të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar; - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të kualifikimit profesional. - mund të pranohen edhe individë që kanë aftësi të kufizuar, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë e tyre. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli II-të në KSHK, referuar nivelit II të KEK, e pajis individin me certifikatën profesionale të nivelit dhe suplementin përkatës të punonjësit gjysmë të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim. Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t`i drejtohet tregut të punës për punësim si ndihmës në institucione private dhe shtetërore që ofrojnë shërbime sociale dhe shëndetësore, shoqërues i personave me aftësi të kufizuar, shoqërues i personave të sëmurë kronik, shoqërues i personave të moshuar, mbështetës për fëmijët në nevojë, mbështetës për viktimat e dhunës në familje, mbështetës për viktimat e trafikimit dhe personat që kanë varësi të ndryshme, etj.</p> <p>Me përfundimin e arsimimit për “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli II-të në KSHK, referuar nivelit II të KEK, individi ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin III të kualifikimit profesional, njëvjeçar. Me arsimimin e mëtejshëm individi fiton të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data e validimit	Korrik 2023			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	O-I-12; O-I-17			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli II në KSHK, individi zotëron njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Legjislacioni dhe kuadri rregullator

- Të listojë kuadrin ligjor dhe rregullator kryesor për fushën e shërbimeve social-shëndetësore;
- Të listojë dokumentacionin që përdoret për ofrimin e shërbimeve social-shëndetësore;
- Të përshkruajë konceptet bazë të legjislacionit të shërbimeve sociale dhe shëndetësore që janë në fuqi;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullores së brendshme institucionale të ofrimit të shërbimeve sociale;
- Të përshkruajë protokollin e ofrimit të shërbimeve social-shëndetësore;
- Të listojë standardet e shërbimeve sociale;

Organizimi i punës

- Të përshkruajë rëndësinë e marrjes së informacionit të saktë dhe të plotë në marrëdhënie pune;
- Të përshkruajë elementët e planit ditor/javor i punës;
- Të listojë burimet e domosdoshme që nevojiten për të zbatuar planin ditor/javor (njerëzore, materiale, financiare, koha, etj.);
- Të shpjegojë rëndësinë e informimit të përfituesit për shërbimet që ai/ajo përfiton;
- Të përshkruajë rëndësinë e sigurimit të një ambienti të përshtatshëm dhe të sigurt të punës;
- Të përshkruajë rregullat e komunikimit etik në marrëdhënie pune dhe ndër personale;
- Të përshkruajë mënyrat e raportimit të punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të një plan ndërhyrjeje individual sipas nevojave të përfituesve;
- Të listojë llojet e shërbimeve social-shëndetësore dhe institucionet përkatëse që i mbulojnë/ofrojnë këto shërbime;
- Të shpjegojë rëndësinë e koordinimit të punës në ofrimin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore;
- Të përshkruajë mënyrën e plotësimit dhe ruajtjes së dokumenteve bazë administrative sipas rastit;
- Të shpjegojë mënyrën e vendosjes së përparësive në punë duke pasur parasysh aftësitë e personave që u shërbehet, mjedisin, burimet, kufizimet etj.;

Aktivitetet e përditshme

- Të shpjegojë ç’është ndërhyrja sociale dhe mirëqenia sociale;

- Të përshkruajë aspektet sociale të komunitetit ku ndërvepron;
- Të klasifikojë individin/grupet në nevojë;
- Të shpjegojë konkretisht një sjellje jo të shëndetshme dhe shkaqet e mundshme të saj;
- Të dallojë sjelljet paragjyquese dhe mënyrat e shmangies së tyre;
- Të dallojë rastet e diskriminimit dhe mënyrat e shmangies së tyre;
- Të listojë llojet e diskriminimit;
- Të listojë llojet e shërbimeve për grupet në nevojë (individë me aftësi të kufizuara, të moshuarit, fëmijët, gratë dhe vajzat e trafikuar dhe të dhunuara etj.)
- Të listojë llojet e aktiviteteve ditore të nevojshme për përfituesit;
- Të përshkruajë cilat janë kushtet optimale higjieno-sanitare sipas protokolleve dhe standardeve të cilësisë së ofrimit të shërbimeve social-shëndetësore;
- Të klasifikojë llojet e materialeve dhe pajisjeve që përdoren në ofrimin e shërbimeve social-shëndetësore;
- Të listojë njësitë shitëse për blerjen e materialeve, mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për aktivitetet e përditshme (p.sh kancelari, farmaci, supermarketet, dyqane veshjes, etj.);
- Të përshkruajë rëndësinë e mbajtjes së shënimeve të sakta lidhur me konsumimin e materialeve gjatë procesit të punës;
- Të përshkruajë metodat për zgjidhjen e konflikteve dhe mos marrëveshjeve në vendin e punës;
- Të listojë teknikat për zgjidhjen e problemeve dhe të shpjegojë qasjen e komunikimit të orientuar ndaj problemit me atë të zgjidhjes së konfliktit;
- Të përshkruajë përdorimin dhe funksionet e pajisjeve kryesore elektro-shtëpiake (sobë, lavatriçe, frigorifer etj.).
- Të përshkruajë rëndësinë e aksesueshmërisë (karrige me rrota, rampa, paterica etj..) në ofrimin e shërbimeve social-shëndetësore.

Nevojat jetike

- Të përshkruajë rregullat për akomodim të përshtatshëm të përfituesve;
- Të përshkruajë rëndësinë e bashkëpunimit me ekipin shumë disiplinor të ofrimit të shërbimeve sociale dhe shëndetësore;
- Të përshkruajë rregullat për sigurimin e higjienës personale të përfituesit;
- Të shpjegojë procedurat e zhveshjes/veshjes së përfituesit;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të dietës ushqimore sipas udhëzimeve të dietologut;
- Të shpjegojë rëndësinë e informimit të personelit mjekësor mbi rastet e pamundësisë së përfituesve për t'u vetë ushqyer;
- Të listojë procedurat e ushqyerjes në krevat;
- Të listojë llojet e ndotjes dhe masat parandaluese.

Nevojat shëndetësore

- Të listojë deficitet e ndryshme psiko-motore sipas grupmohave;
- Të dallojë deficitet lokomotore;
- Të listojë nevojat bazë për individin sipas problemeve shëndetësore;

- Të përshkruajë njohuritë bazë mbi patologjitë kronike të shëndetit;
- Të përshkruajë problematikat shëndetësore sipas grup moshave;
- Të rendisë etapat e procedurës për dhënien e ndihmës së parë;
- Të tregojë format farmaceutike të barnave;
- Të listojë rregullat e kujdesit në përdorimin e barnave;
- Të listojë rrugët e marrjes së barnave;
- Të përshkruajë trajtimet me barna alternative;
- Të përshkruajë mënyrën e shpërndarjes, si dhe metabolizmin e barnave në organizëm;
- Të përshkruajë efektet anësore të barnave;
- Të rendisë procedurat për matjen e shenjave jetësore;
- Të shpjegojë rëndësinë e informimit të mjekut për çdo problem shëndetësor të përfituesit;
- Të listojë hapat që ndiqen në parandalimin e sëmundjeve infektive;
- Të shpjegojë rëndësinë e shoqërimit të përfituesve në qendra shëndetësore apo spitalore;
- Të përshkruajë mbështetjen që ofrohet për individët me sëmundje të rënda dhe për ata që janë në prag të vdekjes;
- Të përshkruajë proceset e pastrimit, dezinfektimit dhe sterilizimit të pajisjeve mjekësore;
- Të përshkruajë procedurat për seleksionimin dhe ndarjen e mbetjeve spitalore.

Nevojat edukative

- Të përshkruajë mënyrat e identifikimit të nevojave edukative sipas kategorive;
- Të listojë burimet për realizimin e aktiviteteve edukative;
- Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të dëshirave të përfituesve;
- Të përshkruajë rëndësinë e koordinimit dhe raportimit të punës me specialistët përkatës;
- Të përshkruajë mënyrat e motivimit të përfituesve me qëllim përfshirjen e tyre në aktivitete edukative;
- Të listojë llojet e aktiviteteve edukative, ndërjegjësuere, informuese, kreative me qëllim përshtatjen e tyre sipas kategorive;
- Të përshkruajë ecurinë edukative të përfituesve;
- Të përshkruajë nevojat, prirjet dhe talentet në fusha të ndryshme të përfituesve;
- Të përshkruajë mënyrën e dokumentimit të veprimtarisë së kryer;
- Të listojë disa mënyra organizimi me qëllim realizimin e aktiviteteve edukative apo argëtuese;
- Të përshkruajë rregullat e monitorimit të përfituesve gjatë zhvillimit të aktiviteteve edukative;
- Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit etik në punën edukative me përfituesin;
- Të përshkruajë teknika “thyerje-akulli” (shaka, histori komike, etj.) me qëllim krijimin e një klime sa më të mirë bashkëpunimi;

Nevojat argëtuese

- Të përshkruajë llojet e aktiviteteve argëtuese sipas grup moshave;

- Të listojë bazën materiale të nevojshme për realizimin e aktiviteteve argëtuese;
- Të listojë llojet e aktiviteteve artistike kulturore të përshtatshme për kategoritë e përfituesve;
- Të listojë aktivitetet sportive të përshtatshme për kategoritë e përfituesve;
- Të listojë aktivitetet kreative të përshtatshme për kategoritë e përfituesve;
- Të listojë aktivitetet okupacionale të përshtatshme për kategoritë e përfituesve;
- Të përshkruajë rëndësinë e nxitjes së aftësive të përfituesve për përfshirje në punë artizanale apo aktivitete të tjera në përputhje me aftësitë dhe dëshirat;
- Të listojë lloje të aktiviteteve promovuese dhe ndërgjegjësuese;
- Të përshkruajë rëndësinë e kalendarit të festave zyrtare dhe ditëlindjeve të përfituesve;
- Të përshkruajë teknika të ndryshme argëtimi në funksion të aktivitetit social në varësi të hapësirës dhe kohës në dispozicion;

Marrëdhëniet familjare dhe shoqërore

- Të shpjegojë rëndësinë e procesit të socializimit të individit;
- Të listojë kontaktet dhe llojet e komunikimit me familjarë dhe rrethin shoqëror;
- Të përshkruajë rëndësinë e informimit të familjarëve mbi ecurinë e përfituesit;
- Të përshkruajë rëndësinë e sigurimit të një mjedisi të veçantë për realizimin e takimeve;
- Të përshkruajë format dhe mjetet e ndryshme për marrjen e përshtypjeve të familjarëve mbi cilësinë e ofrimit të shërbimeve;
- Të përshkruajë mënyrat e sjelljes, komunikimit dhe inkurajimit në raste të fatkeqësive të përfituesve;

Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit

- Të përshkruajë llojet e mjeteve të ndihmës së parë;
- Të përshkruajë mënyrat e ofrimit të ndihmës së parë;
- Të përshkruajë rregulloren e sigurimit teknik për shëndetin dhe sigurinë në punë;
- Të përshkruajë faktorët ndikues në ndotjen e mjedisit;
- Të përshkruajë rëndësinë e udhëzimeve për mbrojtjen ndaj mbetjeve të kontaminuara, me lëndë kimike apo biologjike dhe trajtimin të tyre;
- Të listojë llojet e detergjenteve ose lëndëve dezinfektuese, të duhura për ambientin ku zhvillojnë aktivitetin e tyre ditor duke përshkruar përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
- Të përshkruajë situatat emergjente në mjedisin ku ofrohet shërbimi;
- Të listojë llojet e sinjalistikës në mjedisin e punës dhe procedurat e evakuimit;
- Të listojë llojet e mbetjeve urbane dhe spitalore;
- Të shpjegojë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit;
- Të tregojë rëndësinë e njohjes dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit;

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të përshkruajë parimet themelore të etikës profesionale;
- Të përshkruajë teknikat dhe rregullat e komunikimit sipas grup moshave;

- Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore dhe fetare në vendin e punës;
- Të përshkruajë hapat e ndërhyrjes për mbrojtjen e individëve në rast abuzimi;
- Të përshkruajë mënyrën e sjelljes ndaj përfituesit për shërbimet e kërkuara;
- Të përshkruajë mënyrën e komunikimit në rast pamundësie të ofrimit të shërbimit të kërkuar;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e zbatimit të rregullave në lidhje me etikën, konfidencialitetin etj.;
- Të listojë llojet e komunikimit dhe përdorimet e tyre (verbal, joverbal; formal dhe jo-formal etj.);
- Të përshkruajë llojet e mjeteve të komunikimit sipas nevojës së personit që i ofrohet shërbimi;
- Të përshkruajë rëndësinë e identifikimit të pengesave në procesin e komunikimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e një komunikimi efektiv;
- Të shpjegojë rëndësinë e punës në grup;
- Të përshkruajë qasjet/metodat për zgjidhjen e konflikteve;
- Të përshkruajë teknikat e motivimit për të nxitur komunikimin;
- Të përshkruajë “dëgjimin aktiv” dhe rëndësinë e tij në marrëdhënie pune;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të TIK në marrëdhënie pune;
- Të përshkruajë rëndësinë e vlerësimit, vetëvlerësimit, motivimit të brendshëm dhe të jashtëm;

Zhvillimi tërësor i njeriut

- Të përshkruajë qëllimin dhe rëndësinë e studimit psiko-pedagogjik të njeriut;
- Të përshkruajë aspekte të zhvillimit biologjik të individit në stadi të ndryshme zhvillimi;
- Të identifikojë ndryshimet e njeriut gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit;
- Të përshkruajë shërbimet që duhet të kryhen në përputhje me fazat e zhvillimit të individit;
- Të përshkruajë zhvillimin psikologjik në moshat e hershme dhe në moshat e rritura;
- Të përshkruajë gjendjen psiko-emocionale të përfituesit;
- Të përshkruajë zhvillimin fiziko-motor të të porsalindurve dhe foshnjave;
- Të listojë anomalitë biologjike që mund të shfaqen në fazat e ndryshme të zhvillimit të individit;
- Të japë shembuj të problemeve të sjelljes që mund të ndeshen në zhvillimin e individit;
- Të listojë disa nga faktorët që mund të ndikojnë në sjelljen e individit;
- Të përshkruajë aspekte të zhvillimit fizik të individit në fëmijëri;
- Të dallojë ndryshimet në zhvillimin fizik të fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Të listojë disa nga karakteristikat e zhvillimit social në fëmijëri;
- Të përshkruajë disa nga ndryshimet biologjike dhe sociale të individit në adoleshencë;
- Të përshkruajë aspektet sociale dhe nevojat e individëve të moshës së tretë;
- Të listojë disa nga sëmundjet më të shpeshta të moshës së tretë;
- Të përshkruajë disa nga shërbimet e nevojshme për individët e moshës së tretë.

Higjiena

- Të përshkruajë çfarë është higjiena dhe rëndësia e saj;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të standardeve dhe rregullave të higjienës;
- Të përshkruajë parimet bazë të higjienës dhe rolin e saj në ruajtjen e shëndetit;
- Të përshkruajë rregullat e higjienës sipas patologjive të shëndetit, aftësive të kufizuara dhe sipas grup moshave;
- Të përshkruajë rregullat e parandalimit të përhapjes dhe transmetimit të infeksioneve;
- Të rendisë etapat e higjienës personale dhe intime;
- Të dallojë rregullat e higjienës në rastin e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe sëmundjeve të tjera infektive;
- Të listojë masat që merren për ruajtjen e higjienës personale;
- Të përshkruajë kushtet e higjienës në mjedisin ku ofrohet shërbimi;
- Të përshkruajë normat dhe rregullat e sjelljes për ruajtjen e higjienës në mjedise të shtëpisë dhe ato publike;
- Të dallojë llojet e dezinfektantëve dhe mënyrën e përdorimit;
- Të përshkruajë mjetet kryesore të punës dhe përdorimin e tyre në ruajtjen e higjienës;
- Të listojë veprimet që çojnë në cenimin e higjienës personale dhe publike;
- Të listojë llojet e kontaminimit dhe masat parandaluese;
- Të listojë pajisjet/mjetet mbrojtëse individuale gjatë ofrimit të shërbimit.

II - SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në "Shërbime sociale/shëndetësore" niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, individit përveç shprehitë profesionale të mëposhtme:

Legjislacioni dhe kuadri rregullator

- Të zbatojë legjislacionin në fuqi gjatë ofrimit të shërbimit social-shëndetësor;
- Të zbatojë rregulloren e brendshme institucionale gjatë ofrimit të shërbimeve social-shëndetësore;
- Të zbatojë protokollin dhe standardet e ofrimit të shërbimeve social-shëndetësore.

Planifikimi i punës

- Të mbledhë informacion të saktë dhe të plotë në lidhje me punën që do të kryejë;
- Të zbatojë planin ditor/javor të punës;
- Të përdorë burimet e domosdoshme që nevojiten për të zbatuar planin ditor/javor;
- Të informojë përfituesin për shërbimet që ai/ajo përfiton;
- Të sigurojë një ambient të përshtatshëm dhe të sigurt pune në mënyrë që përfituesi të marrë shërbime cilësore;
- Të zbatojë rregullat e komunikimit etik në marrëdhënie pune dhe ndërpersonale;
- Të raportojë për punën e kryer sipas formateve të kërkuara dhe hierarkisë;
- Të ruajë dokumentacionin e punës në përputhje me udhëzimet;
- Të zbatojë planin individual të përfituesit sipas nevojës;

- Të koordinojë punën me palë të tjera që ofrojnë shërbime social-shëndetësore;
- Të plotësojë dokumentet administrative bazë;
- Të organizojë realizimin e detyrave të tij/saj sipas prioriteteve dhe nevojave që shfaqen.

Aktivitetet e përditshme

- Të ofrojë shërbimet për persona dhe grupe në nevojë sipas tipologjive përkatëse;
- Të ofrojë shërbime cilësore për përfituesit në përputhje me protokollet dhe standardet e shërbimeve social-shëndetësore;
- Të ndërhyjë për shmangien e sjelljeve paragjyquese, diskriminuese që shfaqen në mjedisin e punës;
- Të ofrojë shërbimet social-shëndetësore për grupe të ndryshme në nevojë (individë që kanë varësi nga substancat narkotike, për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, persona me aftësi të kufizuar etj.);
- Të organizojë aktivitete të ndryshme ditore në funksion të plotësimit të nevojave të përfituesit;
- Të mirëmbajë kushtet optimale higjieno-sanitare sipas protokolleve dhe standardeve të cilësisë të ofrimit të shërbimeve social-shëndetësore;
- Të përdorë materialet, mjetet dhe pajisjet e përshtatshme për ofrimin e shërbimeve social-shëndetësore;
- Të dokumentojë në mënyrë periodike konsumimin e materialeve/mjeteve të punës;
- Të parandalojë konfliktet dhe mosmarrëveshjet që lindin në vendin e punës;

Nevojat jetike

- Të zbatojë rregullat për akomodim të përshtatshëm të përfituesve;
- Të bashkëpunojë me stafin shumë disiplinor për ofrimin e shërbimit social dhe shëndetësor;
- Të zbatojë rregullat për sigurimin e higjienës personale të përfituesit;
- Të kryejë procedurat e zhveshjes/veshjes së përfituesit;
- Të zbatojë dietën ushqimore sipas udhëzimeve të dietologut;
- Të informojë personelin mjekësor mbi rastet e pamundësisë së përfituesve për t'u vetë ushqyer;
- Të zbatojë procedurat e ushqyerjes në krevat;
- Të zbatojë masat parandaluese për evitimin e kontaminimit;

Nevojat shëndetësore

- Të vëzhgojë gjendjen shëndetësore të përfituesit;
- Të plotësojë nevojat bazë për individin sipas problemeve shëndetësore;
- Të vëzhgojë ecurinë e patologjive kronike të shëndetit;
- Të parandalojë problematikat shëndetësore sipas grup moshave;
- Të zbatojë hapat për dhënien e ndihmës së parë;
- Të dallojë format farmaceutike të barnave;
- Të zbatojë rregullat e kujdesit në përdorimin e barnave;
- Të ndihmojë personelin mjekësor gjatë aplikimit të barnave në rrugë të ndryshme;
- Të zbatojë udhëzimet e mjekut për trajtimet me barna alternative;

- Të monitorojë përfituesin gjatë marrjes së barnave;
- Të vëzhgojë efektet anësore të barnave gjatë përdorimit të tyre;
- Të zbatojë procedurat për matjen e shenjave jetësore;
- Të informojë mjekun për çdo problem shëndetësor të përfituesit;
- Të zbatojë rregullat për parandalimin e sëmundjeve infektive;
- Të shoqërojë përfituesin në qendra shëndetësore apo spitalore;
- Të mbështesë individët me sëmundje të rënda dhe ata që janë në prag të vdekjes;
- Të kryej pastrimin, dezinfektimin dhe sterilizimin e mjeteve/ pajisjeve mjekësore;
- Të seleksionojë mbetjet spitalore;

Nevojat edukative

- Të identifikojë nevojat edukative sipas kategorive;
- Të përdorë burimet për realizimin e aktiviteteve edukative;
- Të respektojë dëshirat e përfituesve;
- Të bashkëpunojë me specialistët përkatës për realizimin e aktiviteteve edukative;
- Të motivojë përfituesit me qëllim përfshirjen e tyre në aktivitete edukative;
- Të përzgjedhë llojet e aktiviteteve edukative, ndërjegjësuese, informuese, kreative, me qëllim përshtatjen e tyre sipas kategorive;
- Të ndjekë ecurinë edukative të përfituesve;
- Të identifikojë nevojat, prirjet dhe talentet në fusha të ndryshme të përfituesve;
- Të dokumentojë veprimtarinë e kryer;
- Të organizojë aktivitete edukative;
- Të monitorojë përfituesit gjatë ofrimit të shërbimit;
- Të komunikojë me etikë në punën edukative me përfituesin;
- Të përdorë teknika “thyerje-akulli” (shaka, histori komike, etj.) me qëllim krijimin e një klime sa më të mirë bashkëpunimi.

Nevojat argëtuese

- ;
- Të përzgjedhë burimet njerëzore dhe bazën materiale të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve argëtuese;
- Të përzgjedhë llojet e aktiviteteve artistike kulturore, me qëllim përshtatjen e tyre sipas kategorive dhe dëshirave të përfituesve;
- Të organizojë aktivitetet sportive sipas kategorive të përfituesve;
- Të organizojë aktivitetet kreative sipas kategorive të përfituesve;
- Të organizojë aktivitetet okupacionale sipas kategorive të përfituesve;
- Të identifikojë aftësitë e përfituesve në punë artizanale;
- Të organizojë aktivitetet promovuese dhe ndërjegjësuese;
- Të dallojë nevojat, prirjet dhe talentet në fusha të ndryshme të përfituesve;
- Të zbatojë kalendarin e festave zyrtare dhe ditëlindjet e përfituesve;
- Të përzgjedhë teknika të ndryshme argëtimi në funksion të aktivitetit social në varësi të hapësirës dhe kohës në dispozicion.

Marrëdhëniet familjare dhe/ose shoqërore

- Të vlerësojë nevojën e përfituesit për socializimë;
- Të vendosë kontaktet dhe llojet e komunikimit me familjarë dhe rrethin shoqëror;
- Të përcaktojë mënyrën e komunikimit me familjarët mbi ecurinë e përfituesit;
- Të krijojë një mjedis të veçantë për realizimin e takimeve;
- Të përcaktojë format dhe mjetet e ndryshme për marrjen e përshtypjeve të familjarëve mbi cilësinë e ofrimit të shërbimeve;
- Të përcaktojë mënyrat e sjelljes, komunikimit dhe inkurajimit në raste të fatkeqësive të përfituesve.

Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit

- Të përdorë mjetet e ndihmës së parë;
- Të japë ndihmën e parë sipas rasteve;
- Të zbatojë rregulloren e sigurimit teknik për shëndetin dhe sigurinë në punë;
- Të identifikojë faktorët ndikues në ndotjen e mjedisit;
- Të zbatojë udhëzimet për mbrojtjen ndaj mbetjeve të kontaminuara, me lëndë kimike apo biologjike dhe për trajtimin e tyre;
- Të përdorë detergjentë ose lëndë dezinfektuese të duhura për mjedisin ku zhvillojnë aktivitetin e tyre ditor;
- Të zbatojë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
- Të identifikojë situatat emergjente në mjedisin ku ofrohet shërbimi;
- Të zbatojë sinjalistikën në mjedisin e punës dhe procedurat e evakuimit;
- Të seleksionojë mbetjet urbane nga mbetjet spitalore;
- Të kryejë procedurat për mbrojtjen e mjedisit;
- Të zbatojë ligjin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit;
- Të zbatojë protokollet përkatëse në raste pandemie

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të zbatojë parimet themelore të etikës profesionale në ushtrimin e profesionit;
- Të marrë vendime në përputhje me etikën profesionale;
- Të komunikojë në përshtatshmëri me grupmoshat dhe nivelit zhvillimor të përfituesve;
- Të respektojë barazinë gjinore, racore, kombëtare, kulturore dhe fetare në vendin e punës;
- Të komunikojë me profesionalizëm me përfituesit lidhur me shërbimet që ata kërkojnë;
- Të sqarojë klientin në mënyrë profesionale dhe etike, lidhur me pamundësinë e ofrimit të shërbimit;
- Të ndjekë metodat e ndërhyrjes në familjet me problematika të ndryshme;
- Të zbatojë rregullat, etikën dhe të ruajë konfidencialitetin në ofrimin e shërbimeve;
- Të adresojë pengesat që mund të shfaqen në procesin e komunikimit;
- Të punojë në grup me kolegët duke pasur në konsideratë përfitimet e punës në grup;
- Të zbatojë qasje/metoda të ndryshme në zgjidhjen e konflikteve në varësi të situatave;
- Të nxisë komunikim ndërmjet përfituesve, stafit, familjarëve të përfituesit;
- Të dëgjojë në mënyrë aktive në marrëdhënie pune;
- Të përdorë TIK në marrëdhënie pune.

Zhvillimi tërësor i njeriut

- Të ofrojë shërbime në përputhje me fazat e zhvillimit të individit;
- Të identifikojë gjendjen psiko-emocionale të përfituesit;
- Të dallojë ecurinë e shëndetit të përfituesit;
- Të identifikojë probleme të sjelljes që mund të ndeshen te përfituesi;
- Të identifikojë faktorët që mund të ndikojnë në sjelljen e individit;
- Të dallojë ndryshimet në zhvillimin fizik të fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Të dallojë disa nga karakteristikat e zhvillimit social në fëmijëri;
- Të dallojë disa nga ndryshimet biologjike dhe sociale të individit në adoleshencë;
- Të identifikojë aspektet sociale dhe nevojat e individëve të moshës së tretë;
- Të ofrojë shërbimet përkatëse për moshën e tretë duke përfshirë dhe të moshuar me sëmundje kronike;.

Higjiena

- Të zbatojë standardet dhe rregullat e higjienës;
- Të zbatojë rregullat e higjienës sipas patologjive të shëndetit, aftësive të kufizuara sipas grup moshave;
- Të zbatojë rregullat e parandalimit të përhapjes dhe transmetimit të infeksioneve;
- Të zbatojë etapat e higjienës personale dhe intime;
- Të zbatojë rregullat e higjienës në rastin e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe sëmundjeve të tjera infektive;
- Të zbatojë normat dhe rregullat e sjelljes për ruajtjen e higjienës në mjedise të shtëpisë dhe ato publike;
- Të përdorë dezinfektantët sipas manualit të përdorimit;
- Të përdorë mjetet kryesore të punës për ruajtjen e higjienës;
- Të përdorë pajisjet/mjetet mbrojtëse individuale gjatë ofrimit të shërbimit.

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij/saj dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij/saj personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;

- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj;
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë eficiente me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
- Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.
- Të demonstrojë aftësi të transmetojë informacionin dhe feedback;
- Të demonstrojë fleksibilitet në punë;
- Të hulumtojë informacione që lidhen me ushtrimin e profesionit.